



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT



Shërbimi Këshillimor Bujqësor Rural i Kosovës
Kosovo Agriculture and Rural Development Advisory Services
Poljoprivredna Ruralna Savetodavna Služba Kosova



KOSOVA DEVELOPMENT CENTER
QENDRA KOSOVARE PËR ZHVILLIM
Address: Dëshmorët e Lirisë nr.135 Gjakovë-Kosovë
Tel: +383 38 724 499 Email: kdc.gjakov@yahoo.com
www.kdc-ks.org

Mbarështimi, shëndeti dhe mirëqenia e Bagëtive, rrugëtimi nga ferma deri në treg



Hyrje

Mbarështimi i bagëtitve është një sektor i rëndësishëm në bujqësi dhe agrobiznes, që ndikon drejtpërdrejt në prodhimin e qumështit, mishit dhe nënprodukteve të tjera. Për të siguruar një prodhim të qëndrueshëm dhe cilësor, është e nevojshme të zbatohen praktika të mira në mbarështim, kujdes shëndetësor dhe mirëqenie të kafshëve. Mbarështimi përfshin përzgjedhjen e racave, përmirësimin gjenetik dhe menaxhimin e riprodhimit për të arritur qëllimet e prodhimit. Përzgjedhja e racave qumështore dhe për mish.

Racat qumështore dhe kombinimi qumësht-mish:

- **Lopa Holstein** - Jep prodhim të lartë të qumështit.
- **Lopa Jersey** - Jep qumësht me përmbajtje të lartë të yndyrës.
- **Lopa Simmental** - Jep prodhim të kombinuar të qumështit dhe mishit. Është njohur për prodhimin e mishit cilësor dhe për përshtatshmërinë e saj në kushte të ndryshme mjedisore, e sidomos në Kosovë, që është përshtatur më së miri me kushtet tona.
- **Lopa Brown Swiss** - Jep qumësht cilësor me përmbajtje të lartë të proteinave.
- **Lopa Montbeliarde** - Jep cilësinë më të mirë të qumështit me yndyrë 4.2%, por gjithashtu ofron një prodhim mishi që përbën 65 deri në 75% të peshës së saj.



Foto 1: Raca Holstein



Foto 2: Raca Jersey



Foto 3: Raca Simmental



Foto 4: Raca Brown Swiss



Foto 5: Raca Montbeliarde

Zgjidhni racat më të përshtatshme për klimën dhe kushtet tuaja, që të arrini prodhime të lartë dhe produktivitet maksimal

Racat e deleve

- **Delja e Kosovës** - Është racë autoktone e ka marrë emrin sipas rrafshit të Kosovës, ku është më së shumti e përhapur në vend.
- **Delja e Sharrit** - Është racë tjetër autoktone, e përshtatur për kushtet malore të rajonit të Sharrit.
- **Delja Balusha (Bardhoka)** - E njohur për pamjen e saj unike, është racë autoktone është e përhapur kryesisht në rrafshin e Dukagjinit.
- **Delja Rude** - E përhapur në Kosovë, kjo racë është e njohur për qëndrueshmërinë dhe përshtatshmërinë e saj në kushte të vështira.
- **Delja Romanovka** - Një racë e rrallë dhe shumë pjellore, e cila është prezentë edhe në Kosovë.



Foto 6: Delja e Kosovës

Racat e dhive

- **Dhia e Hasit** - Është racë autoktone shtrihet në zonën e veriut të Shqipërisë dhe në një pjesë të Kosovës.
- **Dhia Alpine** - Është racë e madhe me origjinë nga Franca, e cila ka një prodhimtari të lartë të qumështit, prej 600-800 litra gjatë një laktacioni.
- **Raca të rralla të kryqëzuara të dhive** - Në Kosovë, disa fermerë kanë filluar të kultivojnë lloje të rralla të dhive, duke kontribuar në diversifikimin e blegtorisë në vend.

Ofroni ushqim të ekuilibruar për bagëtitë dhe me vlera ushqyese të larta për produkte cilësore dhe me vlera të larta ushqimore



Foto 7: dhia Alpin

Përbërësit kryesorë të ushqimit të ekuilibruar për kafshë:

Energjia - Bar i thatë, sanë, kashte, misër, elbi, grurë, silazh. Përdoret për aktivitet jetësor, prodhim të qumështit dhe rritje trupore.

Proteinat - Sojë, jonxhë dhe koncentre proteinike, të cilat ndihmojnë në ndërtimin e muskujve dhe prodhimin e qumështit.

Fibra - Sanë, bar i freskët, silazh, kashte. E rëndësishme për sistemin tretës të kafshëve.

Vitaminat dhe mineralet - Kripë, fosfor, kalcium, vitamina A, D, E, suplemente minerale. Thelbësore për shëndetin e eshtrave, sistemin imunitar dhe pjellori.

Uji i pastër dhe i mjaftueshëm, i cili duhet të jetë gjithmonë i qasshëm.

Ushqimi i ekuilibruar për lopë (posaçërisht lopë qumështore):

- ✓ **Silazh misri ose sanë me cilësi të mirë** (burim i energjisë dhe fibrës),
- ✓ **Koncentrat proteinik** (sojë, byk luledielli),
- ✓ **Kripë dhe minerale** sipas nevojës,
- ✓ **Ujë i bollshëm** (lopët mund të pijnë 60-100 litra ujë në ditë).

Ushqimi i ekuilibruar për dele:

- ✓ **Sanë i pasur me proteina** (jonxhë),
- ✓ **Koncentrat me drithëra dhe proteina**, sidomos mbarsemët dhe laktacionit,
- ✓ **Lëndë minerale për dele**, sidomos për të shmangur mungesën e bakrit dhe selenit,
- ✓ **Uji i pastër** çdo ditë.

Ushqimi i ekuilibruar për dhi:

- ✓ **Bar i freskët ose sanë cilësor,**
- ✓ **Silazh dhe koncentre,** sidomos për dhi qumështore,
- ✓ **Kripë dhe minerale specifike për dhi,**
- ✓ **Ujë në sasi të mjaftueshme,** sidomos gjatë laktacionit.

Shëndeti dhe mirëqenia e bagëtive - Shëndeti dhe mirëqenia e bagëtive janë faktorë kyç për produktivitetin dhe qëndrueshmërinë e fermave/blegtorisë. Një menaxhim i mirë i shëndetit të kafshëve siguron prodhim të lartë, cilësi më të mirë të produkteve dhe uljen e përdorimit të antibiotikëve.

1. Faktorët që ndikojnë në shëndetin dhe mirëqenien e bagëtive:

Ushqimi i balancuar - Një dietë e shëndetshme ndihmon në rritjen, prodhimin dhe mbrojtjen nga sëmundjet.

Kushtet e strehimit - Ventilimi i mirë, hapësira e mjaftueshme dhe higjiena zvogëlojnë stresin dhe rreziqet shëndetësore.

Menaxhimi i stresit - Stresi ndikon negativisht në prodhimin e qumështit dhe shëndetin riprodhues.

Parandalimi i sëmundjeve - Vaksinimi dhe kontrollet e rregullta veterinare parandalojnë përhapjen e infeksioneve.

Përdorimi i qëndrueshëm i antibiotikëve - Ulja e përdorimit të tepërt të antibiotikëve zvogëlon rrezikun e rezistencës antimikrobiale.

Racion ditor i balancuar për një lopë në laktacion.

Përbërësi	Sasia e rekomanduar
Sanë jonxhe	5-7 kg
Silazh misri	20-25 kg
Koncentrat proteinik	5-6 kg
Kripë + minerale	100-150 g
Ujë i pastër	40-100 litra

Racion i balancuar për dele në laktacion

Përbërësi	Sasia e rekomanduar
Sanë jonxhe	1.5-2.0 kg
Drithëra (misër/elb)	0.3-0.5 kg
Koncentrat proteinik	0.2-0.3 kg
Kripë + minerale	30-50 g
Ujë i pastër	4-6 litra

Racion i balancuar për dhi në lakatcion

Përbërësi	Sasia e rekomanduar
Sanë jonxhe	2-3 kg
Silazh ose bar i freskët	3-5 kg
Koncentrat proteinik	0.5-0.7 kg
Kripë + minerale	30-50 g
Ujë i pastër	6-8 litra

2. Sëmundjet më të shpeshta te bagëtitë:

- ✓ Mastiti - Infeksion i gjëndrave të qumështit që ndikon në cilësinë e qumështit.
- ✓ Bruceloza - Një sëmundje bakteriale që shkakton infertilitet dhe humbje të pjellave.
- ✓ Helminet ushqimore - Shkaktuar nga ushqimi i kontaminuar ose i prishur.
- ✓ Parazitët - Infeksionet nga parazitët e brendshëm dhe të jashtëm ndikojnë në rritjen dhe prodhimin.

3. Masat për përmirësimin e mirëqenies së bagëtive:

- ✓ Ushqim i sigurt dhe i kontrolluar - Reduktimi i përdorimit të aditivëve artificialë dhe përdorimi i ushqimeve organike.
- ✓ Krijimi i kushteve të mira të jetesës - Sigurimi i hapësirës së mjaftueshme dhe pastrimi i rregullt i staneve dhe stallave.
- ✓ Monitorimi i shëndetit të kafshëve - Identifikimi i hershëm i sëmundjeve për të parandaluar përhapjen.
- ✓ Zbatimi i praktikave të qëndrueshme - Integrimi i metodave natyrore për të ruajtur ekosistemin dhe shëndetin e kafshëve.

Mbani një ambient të pastër dhe të ajrosur mirë në stallë për mirëqenie dhe shëndet të kafshëve

Aplikimi i standardeve dhe praktikave më të mira në fermën me lopët qumështore - Menaxhimi i duhur i një ferme me lopë qumështore ndikon drejtpërdrejt në prodhimin, cilësinë e qumështit dhe mirëqenien e kafshëve. Aplikimi i standardeve dhe praktikave më të mira siguron prodhim të qëndrueshëm, cilësi të lartë të qumështit dhe mirëqenie të lopëve. Kjo ndihmon fermerët të kenë fitime më të mira dhe të ruajnë mjedisin:

Standardet e ushqimit dhe ujit (Dieta e ekuilibruar, Ushqimi cilësor, Uji i pastër dhe i mjaftueshëm).

Menaxhimi i strehimit dhe hapësirës (Ventilimi dhe ndriçimi i mirë, Hapësirë e mjaftueshme, Shtretër të rehatshëm, Pastërtia dhe dezinfektimi)

Higjiena dhe kujdesi veterinar (Kontrolli i shëndetit, Vaksinimi dhe trajtimi i parazitëve, Monitorimi i gjendjes trupore, Menaxhimi i stresit).

Mjelia dhe cilësia e qumështit (Mjelia higjienike, Rregullshmëria e mjeljes, Testimi i cilësisë së qumështit, Ruajtja e qumështit).

Përmirësimi gjenetik (Zgjedhja e racave të përshtatshme, Inseminimi artificial, Përcaktimi i kohës optimale për riprodhim për të siguruar fekundim të suksesshëm).

Menaxhimi i mbetjeve dhe qëndrueshmëria (Riciklimi i plehut organik, Përdorimi i energjisë së ripërtëritshme, Reduktimi i përdorimit të antibiotikëve).

Përgatitja e planifikimit të një plani mbi të ushqyerit, masat në parandalimin e sëmundjeve - Një plan i mirë i ushqyerjes dhe strategjia për parandalimin e sëmundjeve janë elemente thelbësore për një fermë të suksesshme. Ky plan ndihmon në rritjen e prodhimit të qumështit, shëndetin e lopëve dhe përmirësimin e efikasitetit ekonomik të fermës.

1. Plani i ushqyerjes - Ushqyerja duhet të jetë e balancuar dhe të plotësojë nevojat energjetike, proteinike, vitaminike dhe minerale të lopëve qumështore.

Programi i ushqyerjes sipas fazave të prodhimit

Faza	Nevoja Energjike	Lloji i Ushqimit
Laktacioni i hershëm	Shumë e lartë	Foragjere cilësore + koncentre me proteina të larta
Mes i laktacionit	Mesatare	Dietë e ekuilibruar me fibra dhe energji
Laktacioni i vonë	E ulët	Më shumë foragjere dhe më pak koncentre
Tharja (60 ditë para pjelljes)	E kontrolluar	Dietë me fibra të larta për të shmangur sëmundjet metabolike

2. Masat për parandalimin e sëmundjeve - Higjiena dhe senaxhimi i stallave, Programi i vaksinimit dhe kontrollit shëndetësor, Parandalimi i sëmundjeve kryesore).

Parandalimi i sëmundjeve kryesore tek kafshët

Sëmundja	Shkaku	Masat parandaluese
Mastiti	Bakterial (Staphylococcus, Streptococcus)	Mjellje higjienike, dezinfektim, antibiotikë preventivë
Acidoza Ruminale	Ushqim i pasur me koncentre dhe pak fibra	Rritja e fibrave në dietë, bikarbonat natriumi
Ketoza	Mungesë energjie në ushqim	Ushqyerje me energji të mjaftueshme pas pjelljes
Hipokalcemia (ethet e qumështit)	Mungesë kalciumi para dhe pas pjelljes	Ushqyerje e kontrolluar në fazën e tharjes
Bruceloza	Infeksion bakterial	Vaksinim dhe izolim i kafshëve të prekura
Dermatiti i këmbëve	Lagështi dhe baktere	Stallë e thatë dhe dezinfektim i rregullt

3. Strategjitë për mbarëvajtje afatgjatë (Monitorimi i Performancës, Trajnimi i Punëtorëve, Përdorimi i Teknologjisë, Përdorimi i Biogazit dhe Plehut Organik).

Rrugëtimi i produkteve nga ferma deri në treg - Rrugëtimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale nga ferma deri te konsumatori final përfshin disa etapa kritike që sigurojnë cilësi, siguri ushqimore dhe efikasitet ekonomik.

Prodhimi në fermë - Zgjedhja e racave dhe kultivarëve të përshtatshëm, Menaxhimi i prodhimit, Standardet e sigurisë ushqimore.

Përpunimi dhe përgatitja për transport - Grumbullimi, ruajtja dhe magazinimi, Paketimi, Etiketimi, Përdorimi i ambalazhit të përshtatshëm, Shpërndarja.

Transporti dhe logjistika - Zinxhiri i shpërndarjes për produktet e ndjeshme në kushte të duhura, Planifikimi i rrugëve dhe shpërndarja.

Shitja në treg dhe konsumi final - Shpërndarja në tregje dhe supermarkete, Produktet shiten në tregje lokale, supermarkete ose dyqane të specializuara, Certifikatat e sigurisë ushqimore dhe origjinës garantojnë cilësinë. Marketingu dhe promovimi, Etiketim që thekson origjinën natyrore dhe cilësinë. Përdorimi i platformave digjitale për marketing dhe shitje online. Bashkëpunim me restorante dhe biznese për të rritur kërkesën. Kënaqësia e konsumatorit, Kontrolli i cilësisë për të siguruar që produktet janë në përputhje me pritshmëritë e konsumatorit, Mbledhja e komenteve dhe sugjerimeve për përmirësimin e mëtejshëm.

Rrugëtimi i produkteve nga ferma deri në treg kërkon planifikim të mirë, standarde të larta sigurie dhe logjistikë efektive. Një zinxhir furnizimi i qëndrueshëm siguron produkte të freskëta, të sigurta dhe me vlerë të lartë për konsumatorët.

Menaxhimi i fermës - Menaxhimi i një ferme efektive kërkon planifikim, organizim dhe përdorim optimal të burimeve për të maksimizuar prodhimin dhe fitimin, duke ruajtur qëndrueshmërinë dhe mirëqenien e kafshëve ose kulturave bujqësore. Menaxhimi efikas i fermës përfshin:

Kakto objektivat - Vendos synime të qarta, si rritja e prodhimit të qumështit, përmirësimi i cilësisë së mishit, ose rritja e sipërfaqes së mbjellë.

Analizo burimet - Vlerëso tokën, ujin, stafin dhe kapitalin e disponueshëm.

Strategjia e tregut - Identifiko tregun e synuar, çmimet dhe kanalet e shpërndarjes për produktet e fermës.

Menaxhimi financiar dhe ekonomik i fermës:

Kontabiliteti dhe regjistrimet - Mbajtja e të dhënave për shpenzimet, të ardhurat dhe fitimet.

Buxhetimi dhe investimet - Planifikimi i shpenzimeve për ushqim, medikamente, pajisje dhe teknologji.

Përdorimi i granteve dhe subvencioneve - Shfrytëzimi i fondeve të qeverisë dhe organizatave për të përmirësuar fermën.

Strategjia e çmimeve - Kalkulimi i kostove dhe përcaktimi i çmimeve konkurruese në treg.

Diversifikimi i të ardhurave - Kombinimi i prodhimit të disa produkteve të kërkuar në treg ose zhvillimi i agroturizmit.

Një fermë e menaxhuar mirë është efektive, fitimprurëse dhe e qëndrueshme. Përdorimi i praktikave të menaxhimit të prodhimit, financave, teknologjisë dhe kujdesit mjedisor ndihmon fermerët të rrisin rendimentin dhe cilësinë e produkteve

Strukturuar për shitjen e produkteve në treg, i shfaqur në një tabelë për lehtësim dhe qartësi

Etapa	Aktivitetet	Kanale të shitjes	Marketingu dhe shpërndarjes
Analiza e tregut	Analizimi i konkurrencës	Tregje lokale	Analizë e konsumatorëve dhe kërkesave të tregut
Pozicionimi i produktit	Zgjedhja e produkteve dhe krijimi i markës për diferencim	Dyqane të specializuara	Etiketa dhe marka tërheqëse që theksojnë cilësinë dhe besueshmërinë
Kanale Shitjeje	Përdorimi i kanaleve të ndryshme (dyqane, online, shpërndarës)	Shitje direkte, B2B, online	Përdorimi i reklamave tradicionale dhe digjitale për të promovuar produktin
Shpërndarja dhe Logjistika	Menaxhimi i inventarit dhe transporti i produkteve për në treg	Transport me kamionë frigoriferikë	Menaxhimi i transportit dhe shpërndarjes me kushtet më të mira për ruajtjen e cilësisë së produkteve
Menaxhimi i Çmimeve dhe Fitimi	Kalkulimi i kostos dhe përcaktimi i çmimit të produkteve	Çmimet konkurruese	Analiza e çmimeve dhe strategjitë për rritjen e fitimeve
Marketingu dhe Promovimi	Krijimi i fushatave promociionale për të rritur njohjen e markës	Panaire, media sociale, reklama online	Përdorimi i reklama në rrjete sociale dhe media tradicionale

Përfundimet

- Aplikimi i metodave të përzgjedhjes gjenetike dhe përmirësimit të racave sjell një rritje të produktivitetit, cilësisë së qumështit dhe mishit.
- Përdorimi i teknologjive moderne për monitorimin e shëndetit dhe performancës së bagëtive ndihmon në optimizimin e menaxhimit të tufës.
- Zbatimi i një programi të rregullt vaksinimi dhe kujdesi veterinar redukton ndjeshëm sëmundjet dhe vdekshmërinë tek bagëtitë.
- Kushtet e mira të strehimit, ushqyerja e balancuar dhe liria e lëvizjes ndikojnë pozitivisht në mirëqenien e kafshëve, duke përmirësuar produktivitetin dhe cilësinë e produkteve.
- Praktikrat humane të trajtimit të kafshëve reduktojnë stresin dhe përmirësojnë performancën e tyre.
- Përmirësimi i kushteve të transportit dhe respektimi i standardeve evropiane është thelbësor për tregjet ndërkombëtare.
- Standardet e sigurisë ushqimore dhe certifikimi i produkteve blegtorale rrisin besueshmërinë e konsumatorit dhe qasjen në tregje të reja.
- Investimi në përmirësimin e kushteve të fermave dhe në edukimin e fermerëve mbi praktikrat më të mira blegtorale.
- Zhvillimi i një zinxhiri të integruar të vlerës nga ferma deri në treg për të rritur cilësinë dhe analizën konkurruese të produkteve.
- Krijimi i mekanizmave mbështetës për certifikimin organik dhe promovimin e produkteve të sigurta dhe të qëndrueshme në tregjet vendore dhe ndërkombëtare



Për më shumë informata ju lutem kontaktoni:

MBPZHR- Departamenti i Shërbimeve Këshillimore Teknike

**Rr. “Ukshin Hoti” ndërtesa “Ramiz Sadiku”, Nr.120
10000 Prishtinë**

Tel : +383 38212338 ; +383 200 38 426

Tel/ fax: +383212 987

Kjo broshurë është përgatitur nga KDC, me Projektin “Zhvillimi i Zonave Rurale përmes avancimit të Shërbimeve Këshillimore”, të financuar nga MBPZHR. Përgjegjësinë për përmbajtjen e broshurave e mban KDC.



**KOSOVO DEVELOPMENT CENTER
QENDRA KOSOVARE PËR ZHVILLIM**
Address: Dëshmorët e Lirisë nr.135 Gjakovë-Kosovë
Tel: +383 38 724 499 Email: kdc.gjakov@yahoo.com
www.kdc-ks.org